



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1067 prot.

Tiranë, më 12. 07. 2019

Lënda: Dërgohen rekomandime për projektligjin “Për shtetësinë”.

Z. JULIAN HODAJ
ZËVENDËSMINISTËR
MINISTRIA E BRENDSHME
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, nr. 3, Tiranë

I nderuar Zëvendësministër,

Në vijim të shkresës Tuaj nr. 5329/4 Prot, datë 05.07.2019, me lëndë “Dërgohet projektligji për mendim”, protokolluar me tonën me Nr. 1067, datë 05.07.2019, po ju përcjellim në vijim rekomandimet apo mendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me projektligjin “Për Shtetësinë”.

Dëshirojmë të theksojmë paraprakisht se, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson mjaf pozitivisht nismën e ndërmarrë nga ana e Ministrisë së Brendshme për hartimin e një projektligji të ri “Për shtetësinë”, i cili synon që t'i përgjigjet më mirë dhe më efektivisht problematikave të hasura në zbatim por gjithashtu të diktuar nga nevoja për harmonizimin e kuadrit ligjor shqiptar me atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në këtë fushë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në ushtrim të kompetencës të parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku sanksionohet se: “Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, pasi u njoh me projektligjin “Për shtetësinë”, sjell në vëmendjen Tuaj disa çështje dhe rekomandime që paraqesin rëndësi në lidhje me këtë projekt-akt:

Duke qenë se ky projektligj, sikurse rezulton edhe nga relacioni i tij, është përafruar me Konventën Europiane “*Për shtetësinë*”, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002, sugjerojmë që të ketë disa parashikime më të zgjeruara dhe më ta qarta të parimit të mosdiskriminimit.

Kështu, projektligji “*Për shtetësinë*”, sipas nenit 1 të tij, ka në objekt të tij përcaktimin e parimeve dhe rregullave për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare. Në këtë kuadër:

1. Rekomandojmë që, të shtohet një germe në nenin 3 të projektligjit, ku të parashikohet se:

“Rregullat mbi fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare nuk duhet të përbajnjë dallime apo të përfshijnë ndonjë praktikë, e cila rezulton në diskriminimin mbi bazën e seksit, besimit, racës, ngjyrës ose origjinës kombëtare apo etnike, ose çdo shkak tjetër të parashikuar në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”

Nëpërmjet këtij rekomandimi, nëse do të merret në konsideratë dhe do të reflektohet në ligj, Komisioneri vlerëson se do të garantohet:

- një harmonizim më i plotë i këtij ligji me legjislacionin europian, konkretisht me Konventën Europiane “*Për shtetësinë*”, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002;
 - që çdo rregull, mbi fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare, të hartohet në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit si dhe të zbatohet në praktikë, sipas këtyre parimeve.
 - zgjerimi i listës së shkaqeve të mbrojtura të diskriminimit, duke parashikuar një listë të hapur të shkaqeve për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, konkretisht nëpërmjet vendosjes së shprehjes “**çdo shkak tjetër ..**”. Kjo garanton më shumë mbrojtje për shtetasit të cilët, për shkak të karakteristikave të veçanta të tyre, mund të bëhen viktima të pabarazisë dhe diskriminimit.
2. Rekomandojmë që, të shtohet një germe tjetër në nenin 3 të projektligjit, sipas së cilës të parashikohet se:

“As martesa dhe as zgjidhja e një martese ndërmjet një shtetasi shqiptar dhe një te huaji, si dhe as ndryshimi i shtetësisë nga njeri prej bashkëshorteve gjatë martesës nuk do të ndikojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortit tjetër.”

Nëpërmjet këtij rekomandimi, nëse do të merret në konsideratë dhe do të reflektohet në ligj, Komisioneri vlerëson se do të garantohet:

- një harmonizim më i plotë i këtij ligji me legjislacionin europian, konkretisht me Konventën Europiane “*Për shtetësinë*”, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002, pasi konstatuam se ky parashikim eksplisit nuk është parashikuar në projektligj.

3. Rekomandohet, shtimi i një pike 6 në nenin 17 të projektligjit, ku të parashikohet se:

“Çdo person që ka paraqitur kërkësën, i cili pretendon se është diskriminuar apo është cenuar nga mosbatimi i parimit të trajtimit të barabartë gjatë procedurës, në lidhje me rregullat për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare, sipas këtij ligji, mund të bëjë ankim, përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi apo në gjykatë, në përputhje me afatet dhe rregullat e përcaktuara në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”

Nëpërmjet këtij rekomandimi, nëse do të merret në konsideratë dhe do të reflektohet në ligj, Komisioneri vlerëson se do të garantohet:

- harmonizimi i legjislacionit të brendshëm, konkretisht i ligjit “*Për Shtetësinë*” me Ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” dhe zbatueshmëria efektive e tyre;
- e drejta e ankimimit të një personi apo grapi personash, për cenim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, përpara Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi apo në gjykatë në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”;

4. Rekomandohet që, në nenin 20, pika 1, ku parashikohet se: “Dekreti për fitimin e shtetësisë shqiptare nuk do të ketë efekt nëse, brenda gjashtë muajve nga njoftimi i tij, personi nuk është betuar sipas nenit 17, të këtij ligji”, të shtohet edhe një fjali në këtë nen ose një pike tjeter, ku të parashikohet se:

“Afati i përcaktuar në pikën 1, të këtij nenit, nuk zbatohet, në rast se, për arsyeshme, personi e ka të pamundur të paraqitet për t'u betuar. Ai dërgon kërkësën dhe dokumentacionin shoqëruar pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme për shtyrjen e afatit të betimit, duke përcaktuar një afat të dytë, i cili në asnjë rast nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj nga dita kur përfundon afati i parë”.

Nëpërmjet këtij rekomandimi, nëse do të merret në konsideratë dhe do të reflektohet në ligj, Komisioneri synon që një person, i cili për arsyе objektive, përfshirë ndër të tjera, gjendjen e tij shëndetësore apo vendbanimin, (shkaqe këto të mbrojtura shprehimisht nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”), nuk mund të paraqitet për t’u betuar, brenda afatit ligjor, të mos përjashtohet nga e drejta për “t’u rivendosur në afat”, pa qenë e nevojshme që të fillojë procedurën nga e para. Kjo masë do të mundësonte përshtatje dhe rregullime në një situatë të veçantë, për përfituesit e kësaj të drejte por nga ana tjetër do të mundësonte ekonomi, në kohë dhe aspekte procedurale, të autoriteteve përgjegjëse.

Formulimi i mësipërm, lidhur me afatet dhe aspekte të tjera procedurale, mund të ndryshohet dhe të vendoset nëse do parashikohen në ligj apo në akte nënligjore.

Në përfundim, por jo për nga rëndësia, sugjerojmë që, në grupet ndërinstitucionale të punës, të ngritur për hartimin e projektligjeve, ku mendoni se një vlerë të shtuar mund të sjellin edhe institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, të thirren edhe këto institucione. Konkretisht KMD, si një institucion i pavarur publik, i cili garanton parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me çdo të drejtë të njohur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislationi në fuqi, shprehet e gatshme për të marrë pjesë dhe për të dhënë kontributin e tij edhe në grupe të tillë pune.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, besojmë në ndërhyrjen Tuaj, me qëllim reflektimin në projektligj të rekomandimeve si më sipër.

KOMISIONERI

